



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 182 Prot.

Kamëz, më 18 . 12 . 2020

V E N D I M

Nr. 256 Datë 18 . 12 . 2020

PËR
MIRATIMIN E LISTËS SË FAMILJEVE QË JANË REKOMANDUAR NGA
ADMINISTRATORET SHOQËRORE PËR TRAJTIM ME FONDIN 6% TË BLOK-
NDIHMËS EKONOMIKE

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot më **18.12.2020** në kushte të veçanta si pasojë e masave të ndërmarra për parandalimin e përhapjes së virusit COVID-19, pasi mori në shqyrtim **Projekt-Vendimin Nr.145 Datë 18.12.2020**, mbështetur në Ligjin 57, Datë 18.07.2019 "Mbi Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë" neni 21, VKM – në nr.956, datë 07.12.2016 "Për përcaktimin e kriterëve dhe të detajeve të formulës së unifikuar të pikëzimit për përfitimin e ndihmës ekonomike" dhe shërbimet shoqërore" Kreu IV, pika 2 të Vendimit nr. 955 datë 07.12.2016, të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike" të ndryshuar dhe Udhëzimit nr.5, datë 17.02.2017 "Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6%" të ndryshuar dhe VKM 597 dt., 04.09.2019 kreu 4 pika 3 "Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike". Dhe në VKB nr 47 datë 11.12.2019 "Mbi miratimin e kriterëve për dhënie të ndihmës ekonomike për familjet që nuk janë përfituese nga sistemi i pikëzimit", **Këshilli Bashkiak Kamëz** :

V E N D O S I :

1. Miratimin e listës së **muajit Nëntor prej 67 familjeve** që janë rekomanduar nga administratoret shoqërore për fondin 6% të bllok-ndihmës ekonomike. Fondi për këto familje është **242,420 (dyqind e dyzetë e dy mijë e katërqind e njëzet) lekë**.
2. Lista e familjeve të cituara në pikën 1 të këtij projekt-vendimi paraqitet në Aneksin bashkëlidhur dhe është pjesë e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë.

K R Y E T A R E

MERITA PRENGA

